# *RAPORT*

## Per Auditimin e fondeve dhe shpenzimeve te fushates

## zgjedhore per Organet e Qeverisjes Vendore te vitit 2019

## Per Subjektin Zgjedhor

## Partia Socialdemokrate e Shqiperise

# I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

## A. INFORMACIONI LIGJOR

### i. Kuadri ligjor

- Ligji nr.10091 date 05.03.2009 "Per Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te miratuar"
- Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise, miratuar me ligjin Nr.10019, date 29.12.2008, ndryshuar me ligjin Nr.74/2012 dhe ligjin Nr.31/2015, date 02.04.2015;
- Ligji Nr.8580, date 17.02.2000 "Per Partite Politike" i ndryshuar;
- Udhezimi i KQZ-se Nr.1,date 31.05.2017 "Per perdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet per afishimin e tyre gjate fushates zgjedhore";
- Udhezimi i KQZ-se Nr.2,date 01.06.2017"Per miratimin e procedurave dhe kritereve te perzgjedhjes se listes paraprake dhe emerimit te eksperteve financiare per monitorimin e fushates zgjedhore" dhe standarteve nderkombetare te kontabilitetit te parashikuara ne ligjin per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare;
- Udhezimi i KQZ-se Nr.3,date 02.06.2017 "Per menyren e llogaritjes se kostos financiare te veprimtarive, sherbimeve apo materialeve qe do te perdoren per qellime zgjedhore ose politike, nga Partite Politike gjate fushates zgjedhore.

### ii. Standardet e kontabilitetit të zbatueshme

- Ligji Nr.9228, date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar;

## B. OBJEKTI I AUDITIMIT

### i. Kontrata e shërbimit

Raporti i auditimit te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara gjate fushates zgjedhore per zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te vitit 2019 u pergatit bazuar ne kontraten e lidhur me date 01.06.20198 ,Nr.Prot.5055 me KQZ-ne.

**Vendimi i KQZ-së**

Gjithashtu Raporti i auditimitte fondeve te perfituara dhe te shpenzuara gjate fushates zgjedhore per zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te vitit 2019 u pergatit bazuar ne Vendimin e KQZ-se Nr.740, date 31.05.2019 "Per shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve financiare dhe audituesve ligjore te cilet do te kryejne monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve te fushates zgjedhore nga subjektet zgjedhore per Organet e Qeverisjes Vendore te vitit 2019".

**ii.** Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

**Pergjegjesite e subjektit zgjedhor:**

Auditimi ligjor i detyrueshem i fondeve te perfituara dhe te shpenzuara gjate fushates zgjedhore te vitit 2019 do te kryhet duke u bazuar ne faktin qe subjekti zgjedhor pranon dhe kupton qe ai ka pergjegjesi per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te pasqyrave financiare ne lidhje me fondet e perfituara dhe te shpenzuara gjate fushates zgjedhore 2019.

Subjekti zgjedhor duhet te vere ne dispozicion te Audituesit Ligjor te gjitha dokumentacionin financiar ne lidhje me fushaten zgjedhore te vitit 2019, transaksionet bankare 3 muaj para dhe pas dates se zgjedhjeve dhe cdo informacion tjeter shtese qe Audituesi Ligjor do ta gjykoje te nevojshem per kryerjen e sherbimit te auditimit.

Subjekti zgjedhor duhet ti jape Audituesit Ligjor te drejten e hyrjes ne te gjitha informacionet per te cilat ai eshte ne dijeni se jane te nevojshme per pergatitjen e pasqyrave financiare sic jane regjistrimet, dokumentacioni dhe ceshtje te tjera si dhe te drejten e komunukimit pa kufizim per personat brenda subjektit zgjedhor nga te cilet gjykohet e nevojshme per te marre evidence auditimi.

Si pjese perberese e procesit te auditimit ,Audituesi kerkon nga subjekti zgjedhor te marre prej tij konfirmime me shkrim lidhur me paraqitjet qe do te behen ne lidhje me auditimin.

## Pergjegjesite e Audituesit Ligjor:

Audituesi Ligjor duhet te hartoje Raportin e Auditimit ne perputhje me ligjin nr.10091 date date 05.03.2009 "Per Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te miratuar", ligjin nr.8580 date 17.02.2000 "Per Partite Politike", ndryshuar me ligjin nr.10374 date 10.02.2011 dhe ligjin nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe aktet nenligjore te nxjerra ne baze dhe per zbatim te tyre.

Audituesi Ligjor duhet te kryeje auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë sigurinë e arsyeshme për faktin nëse fondet e perfituara dhe te shpenzuara gjate fushates zgjedhore 2019 përmbajnë ose jo anomali materiale. Auditimi përfshin kryerjen e proçedurave për marrjen e evidencës së nevojshme rreth shumave dhe informacioneve që jepen në pasqyrat financiare. Proçedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit, ku përfshihen vlerësimi i rreziqeve të anomalisë materiale në pasqyrat financiare, i cili vjen nga gabimi apo nga mashtrimi.Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së cmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.Si rrjedhojë e kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, së bashku me kufizimet e vetvetishme të kontrollit të brendshëm, ekziston një rrezik i pamënjanueshëm që disa nga anomalitë materiale të mbeten të pazbuluara, edhe pse auditimi është planifikuar sic duhet dhe kryer në përputhje me SNA-të.

Gjithashtu auditimi duhet te kryhet duke marre parasysh konstatimet e Raportit ne Monitorimit . Ne menyre te vecante audituesi duhet te kerkoje dokumentacion mbeshtetes per zyrat zgjedhore dhe eventet e monitoruara zgjedhore. Shpenzimet e raportuara nga subjekti zgjedhor duhet te krahasohen si me konstatimet e auditimit ashtu edhe me konstatimet e monitorimit.

## c. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR

### i. Prezantimi i subjektit zgjedhor

Ne dokumentacionin ne Zyren e Regjistrimit te Partive Politike, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, rezulton se me urdher nr. 30/1 date 23.04.1991 te Ministrit te Drejtesise eshte miratuar krijimi i Partise "Partia Social Demokratike", me iniciale "PSD". Qellimi dhe objektivat e kesaj partie jane te percaktuara ne program dhe statut. Partia Social Demokratike ka per qellim konkurimin politik permes zgjedhjeve te pergjithshme, ne respekt te vlerave te lirise, barazise dhe drejtesise ne nje gare politike. Ajo synon te promovoje ne interes te Shqiperise dhe Shqipetareve, lirine e mendimit dhe dinjitetin e individit, te drejtat dhe detyrat themelore te tyre, zhvillimin e iniciatives se lire e barazine ne shans, tregun e lire e konkurues si instrument per zhvillimin e shpejte dhe te qendrueshem te vendit, shtetin e se drejtes, sigurine e individit dhe te prones, pergjegjesine individuale e fuqizimin e familjes, drejtesine shoqerore e dialogun social, ruajtjen e natyres dhe te ambientit, autoritetin e shtetit dhe veteqeverisjen e lire te kolektiviteteve lokale.

### ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit (qendra dhe degët rajonale)

Numri i degeve te Partise Socialdemokrate eshte 37 ne 12 qarqe si: Berat, Diber, Durres, Elbasan, Fier, Korce, Kukes, Shkoder, Lezhe, Vlore, Gjirokaster dhe Tirane.

Partia Socialdemokrate ka 12.000 anetare. Struktura organizative e Partise eshte:

- ✓ Seksioni, nen/dega dhe Dega (neni 20 i statutit)

Organet drejtuese te Partise Socialdemokrate jane:

- ✓ Kongresi
- ✓ Konferenca Kombetare,
- ✓ Keshilli Drejtues Kombetar
- ✓ Kryetari dhe
- ✓ Kryesia e PSD.

Adresa e Partise eshte rr. Hoxha Tahsim, nr.187/1, Tirane.

Me vendim te KQZ nr.827 date 06/06/2019 eshte vendosur zevendesimi i emrit te Kryetarit te PSDz.Skender Gjinushi me z. Engjell Bejtaj. Partia Socialdemokrate eshte rregjistruar si subjekt zgjedhor ne zgjedhjet vendore te 30 qershorit 2019 me vendim te KQZ nr.139date 09/04/2019 dhe eshte parti anetare e koalicionit "Alenaca per Shqiperine Europiane" me vendimin nr.251 date 07/05/2019 te KQZ.

## D. PARAQITJA E RAPORTIT DHE STRUKTURA E TIJ

i. Struktura e raportit të auditimit – kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet

Partia Socialdemokrate nuk ka deklaruar asnje shpenzim per fushaten e 30 qershorit, dhe fondet publike te buxhetit te shtetit ne shumen 2,265,102 leke te disbursuara ne date 26/06/2019, nuk jane perdorur dhe plotesojne kriterin qe duhet te kthehen brenda 90 diteve nga data e shpalljes se rezultatit perfundimtar ne KQZ, sipas nenit 24/3 pika 5 e Ligjit 8580 "Per Partite politike" e ndryshuar me Ligjin 90/2017.

ii. Takimet dhe komunikimet midis audituesit ligjordhe subjektit zgjedhor dhe çdo person tjetër të tretë

Pas raportimit financiar te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per fushaten zgjedhore 2019 te subjektit zgjedhor PKD prane KQZ-se, ne filluam procedurat per kryerjen e auditimit ligjor, duke njoftuar nepermjet Leter Angazhimit e cila eshte derguar nepermjet postes zyrtare.

Ne organizuam nje takim me Zn.Lidia Kaltanji, financiare e PSD e cili na dorezoi raportin financiar per fondet e fushates zgjedhore 2019. Gjithashtu na vuri ne dispozicion ne ambjentet e selise se Partise dokumentacionin financiar qe lidhej me auditimin e fondeve te fushates zgjedhore.

iii. Paraqitje e përgjithshme e raportit te financimit të fushatës zgjedhore: nëse është ose jo në përputhje me kërkesat e raportimit.

Raporti i financimit te fushates zgjedhore eshte ne perputhje me kerkesat e raportimit.

## II. KËRKESAT FORMALE

### A. PËRMBLEDHJE

| | | | |
|---|---|---|---|
| **1/ Data e dorëzimit** | | | |
| | a) dorëzim në formë elektronike | Po | 25/11/2019 |
| | b) dorëzim fizik | Po | 26/11/2019 |
| **2/ Nënshkrimi** | | | |
| | Nënshkrimi | Po | 24/11/2019 |
| **3/ Llogariabankaree veçantë / Personi përgjegjës i financës** | | | |
| | a) evidenca e hapjes së llogarisë bankare | Jo | Nuk eshte hapur llogari e posacme bankare per fushaten zgjedhore, eshte perdorur llogaria ekzistuese prane BKT-se e subjektit zgjedhor PKD me numer IBANI AL9020511014000794CLTJCLALL0 |
| | b)Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) që mbulon periudhën e fushatës | Po | 30.03.2019-30.09.2019 |
| | c) identiteti i personit përgjegjës të financës | Po | Lidia Kaltanji |

### B. ANALIZA

**a/ Llogaria bankare e veçantë**

- **A është unike llogaria bankare (vetëm për qëllimin e fushatës zgjedhore) ?**
    - Nuk eshte hapur llogari e posacme bankare per fushaten zgjedhore.

Nuk ka pasur burime te ardhurash monetare dhe ne natyre nga financime jopublike si dhe te ardhura te krijuara nga vete subjekti politik. Nuk ka patur shpenzime per fushaten zgjedhore.

- Subjekti zgjedhor PSD ka perdorur llogarine ekzistuese prane BKT-se nr.IBANi AL90205110140007940CLTJCLALL0 per te marre financimet publike dhe per kryer shpenzimet ne lidhje me fondet vjetore 2019.

- *Nuk ka llogari bankare te fjetura qe jane perdorur per zgjedhje te meparshme.*

- Raporti i financimit te fushates eshte me teprice pasi i gjithe fondi publik eshte i pa perdorur.

- **A është siguruar i gjithë informacioni?**
  - Llogaria e Partise Socialdemokrate prane bankes se nivelit te dyte me IBAN AL90205110140007940CLTJCLALL0 celur ne date 01 korrik 1999 prane Bankes Kombetare Tregetare.
    Personat pergjegjes qe urdherojne transaksionet bankare jane: Engjell Bejtaj dhe Asllan Kokona.
  - Eshte siguruar informacioni ne lidhje me levizjet bankare te llogarise ekzistuese (jo e posacme) prane BKT-se per periudhen 3 muaj para dhe pas dates se zgjedhjeve qe perfshin periudhen 30.03.2019-30.09.2019

**b/ Personi përgjegjës për Financën**

- **Identiteti i personit përgjegjës për financën:**
  - Personi pergjegjes per financat e subjektit zgjedhor PSD eshte Zn. Lidia Kaltanji, ne pozicionin e financiarit tei Partise.
  - Çështje të mospërputhjeve të mundëshme nuk ka.

- **Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore:**
  - Nenshkrimi i raportit te financimit te fushates zgjedhore eshte bere nga financieri Zn.Lidia Kaltanji
  - Përgatitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse: zbulimi i problemeve të paraqitjes (shiko më poshtë)

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | a) mungon informacioni | Po | Financimi i shpenzimeve per anetare te keshillave bashkiake | |
| | b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë) | | | |
| | | ***Të Ardhurat*** | | |
| | | | Financime publike | 2,265,102 |
| | | | Donacione private | 0 |
| | | | Financim nga burimet e veta të partisë | 0 |
| | | | Huatë/Kreditë | 0 |
| | | ***Shpenzimet*** | | |
| | | | Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës | 0 |
| | | | Materialet promovuese | 0 |
| | | | Media | 0 |
| | | | Sondazhe të Opinionit Publik | 0 |
| | | | Botime | 0 |
| | | | Transporti | 0 |
| | | | Konsulenca | 0 |
| | | | Reklamime në ambiente të hapura | 0 |
| | | | Administrative dhe të përgjithshme | 0 |

# III. TË ARDHURAT

## A. PËRMBLEDHJE

| | | Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore | Sipas auditimit të kryer |
|---|---|---|---|
| **1/ Financimi publik** | | | |
| | Shuma e pagesës paradhënie | 2,265,102 | 2,265,102 |
| | Data e tranfertës | 26.06.2019 | 26.06.2019 |
| | Shuma e pagesës së marrë pas zgjedhjeve | 0 | 0 |
| | Data e transfertës | 0 | 0 |
| | Shuma e financimit publik e kthyer, nëse ka | 2,265,102 | 2,265,102 |
| | Data e transfertës | 23.10.2019 | 23.10.2019 |
| **2/ Donacionet private** | | | |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar | 0 | 0 |
| | Shuma e donacioneve në para | 0 | 0 |
| | Shuma e donacioneve në natyrë | 0 | 0 |
| | Përgatitet një listëe donatorëve | | 0 |
| | Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) | | 0 |
| | Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuardhedokumentit të lëvizjeve në llogaritë bakare (bank statement) (shuma) | | 0 |
| | Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bakare (bank statement) (data) | | 0 |
| | Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokuementit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (donatori) | | 0 |
| | Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data) | | 0 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)? | | 0 |
| | Respektimi i kufirit të donacionit | | 0 |
| **3/ Financimi nga burimet e vetë partisë** | | | |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar | 0 | 0 |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore) | 0 | 0 |
| | *Kuotat e anëtarësisë* | 0 | 0 |
| | *Botimet* | 0 | 0 |
| | *Shtypshkronja* | 0 | 0 |
| | *Marrje me qera* | 0 | 0 |
| | Transferte nga llogaria e partise | 0 | 0 |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale) | 0 | 0 |
| | *Kuotat e anëtarësisë* | 0 | 0 |
| | *Botimet* | 0 | 0 |
| | *Shtypshkronja* | 0 | 0 |
| | *Marrje me qera* | 0 | 0 |
| | Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(shuma) | | 0 |
| | Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(data) | | 0 |
| **4/ Huatë/Kreditë** | | | |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar | 0 | 0 |
| | Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua) | 0 | 0 |
| | Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua) | 0 | 0 |
| | Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua) | | 0 |
| **5/ Marrja/Arkëtimii të ardhurave** | | | |
| Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike. | | Jo | Nepermjet llogarise |

| | | |
|---|---|---|
| | | ekzistuese |

**B. ANALIZA**

**a/ Financimi publik**

- Fondi publik i transferuar ne llogarine rrjedhese te PSD prane bankes se nivelit te dyte BKT eshte ne date 26/06/2019 ne shumen 2,265,102 leke e cila eshte rikthyer e plote ne date 23/10/2019 si rezultat i mosperdorimit per fushten zgjedhore 2019.
- Partia Socialdemokrate nuk ka shfrytezuar minutazhin e transmetimit falas. Me vendimin e saj nr.727 date 30/05/2019, KQZ i caktoi PSD 30 minuta kohe falas ne televizion dhe radio publike për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partive parlamentare.
- Nuk ka Raste te abuzimit/keqpërdorimit të burimeve publike.

**b/ Financimi nga burimet jo publike**

Nuk jane raportuar burime jo publike.

- **Burimet e palejuara**

  Nuk ka burime te palejuara
- **Kontributet në natyrë**
  - **Vlerësimi:**

    Nuk ka kontribute ne natyre.

  - **Kufizimet**
    - Kontrolli i shumës së përgjithshme nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror nga një degë e partisë;
    - Kufizimet (pragu i raportimit dhe deklarimit zbatohet si për kontributet në para ashtu edhe për ato në natyrë – *si të garantojmë respektimin e kësaj dispozite kur raportet e financimit të fushatës zgjedhore konsolidojnë llogaritë e selisë së partisë me ato të degëve?)*

**c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike:** Nuk ka financime nga burime te vete partise politike.

- **Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë**
  - Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe e detajuar sipas shumave të marra
  - Botimet
  - Shtypshkronjat

  - Marrja me qera.....
- **Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës**
  - Zyrat Qendrore
  - Degët lokale
- **Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruar dhe deklarimit bankar (bank statement) (mund të përdoret edhe termi *"nxjerrje e llogarisë")***

**d/ Huatë/Kreditë:** Nuk ka financime nga Hua apo Kredi

- Identiteti i huadhënësit/ve
- Shuma dhe data e huasë/ve (paraqitja e kontratës së kredisë / huasë).
- Data e shlyerjes e përcaktuar në kontratën e kredisë / huasë/ve (*problemi i huave të fshira– në rast dyshimi,e rëndësishme që të theksohet)*
- Normat e interesit *(llogaritet tek shpenzimet si një shpenzim zgjedhor?)*

## *IV.* SHPENZIMET

### *A.* PËRMBLEDHJE

| | | |
|---|---|---|
| Shuma e përgjithshme e raportuar | 0 | |
| Respektimi i kufirit të shpenzimit | Po | |

**Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë**

| | **Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të fushatës zgjedhore** | Faturat e paraqitura | Faturat e Përgjithshme | Dokumente mbështetëse që mungojnë | Shpenzime të papaguara | Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët | **Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Mitingjet dheaktivitetet | 0 | | | | | | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| e fushatës | | | | | | | |
| Materialet promovuese | 0 | | | | | | 0 |
| Media | 0 | | | | | | 0 |
| Sondazhet e opinionit publik | 0 | | | | | | 0 |
| Botimet | 0 | | | | | | 0 |
| Transporti | 0 | | | | | | 0 |
| Konsulenca | 0 | | | | | | 0 |
| Reklamat në ambientet e jashtme | 0 | | | | | | 0 |
| Administrative dhe të përgjithshme | 0 | | | | | | 0 |
| **Shpenzimet e bëra nga degët e partisë** | | | | | | | |
| | **Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit te fushatës zgjedhore** | Faturat e paraqitura | Faturat e Përgjithshme | Dokumente mbështetëse që mungojnë | Shpenzime të papaguara | Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët | **Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit** |
| Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës | 0 | | | | | | 0 |
| Materialet promovuese | 0 | | | | | | 0 |
| Media | 0 | | | | | | 0 |
| Sondazhet e opinionit publik | 0 | | | | | | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Botimet | 0 | | | | | | 0 |
| Transporti | 0 | | | | | | 0 |
| Konsulenca | 0 | | | | | | 0 |
| Reklamat në ambientet e jashtme | 0 | | | | | | 0 |
| Administrative dhe të përgjithshme | 0 | | | | | | 0 |
| **Shpenzimet zgjedhore** | | | | | | | |
| Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë | | | | | | | Jo |

### *B.* ANALIZA

**a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve:** Shpenzimet e raportuara nga partia per fushaten zgjedhore per qeverisjen vendore 2019, jane 0 (zero) leke.

**b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruara dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.**

- **Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës (fokusohuni tek këto);**
  - Pagesa për vendin;
  - Shpenzimet e zbavitjes;
  - Shpenzimet e pajisjeve;
  - Shpenzimet për pijet;
  - Shpenzimet e dekorit/vizuales;
  - Shpenzimet e Transportit;
  - Shpenzimet e Administratës;
- **Materialet promovuese**
- **Media**
- **Sondazhet e opinionit publik**
- **Botimet**
- **Transporti**
- **Konsulenca**

- **Reklamat në ambientet e jashtme**
- **Administrative dhe të përgjithshme**

**KUJDES: Për secilën kategori të shpenzimeve, analizoni:**

- Natyrën zgjedhore të shpenzimeve të llogaritura dhe të përfshira në raportin e financimit të fushatës zgjedhore;
- Ekzistencës dhe/ose zbulimit të shpenzimeve të paligjshme (keqpërdorimi i burimeve publike / blerja e votës). Sidoqoftë, këto shpenzime, të paligjshme nga natyra, duhen llogaritur dhe këto shpenzime të llogaritet si tejkalim i kufirit të shpenzimeve.
- Shpenzimeve që janë bërë para fillimit të fushatës zgjedhore (që nga 5 Dhjetori e më pas) duhen llogaritur dhe këto shpenzime të llogariten si tejkalim i kufirit të shpenzimeve.
- *Raportimi i shpenzimeve në natyrë. Duhet të ekzistojë një përputhshmëri me donacionet në natyrë.*

## V. <u>PËRFUNDIMI</u>

### *A.* SINTEZA

- Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve

  Gjate procesit te auditimit te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara te fushates u konstatuan keto gjetje:

  - Subjekti zgjedhor PSD nuk ka hapur nje llogari te posacme bankare per fushten zgjedhore referuar nenit 90, pika 2 e Kodit Zgjedhor.
  - Nuk jane deklaruar shpenzimet per anetare te keshillave bashkiake. Partia Socialdemokrate ka fituar 81 anetare per keshilla bashkiake ne 36 bashki te vendit.

- Krahasimi me raportin e monitorimit të ekspertit financiar:

  Duke e krahasuar me raportin e monitorimit jane te njejtat gjetje dhe perfundime edhe ne raportin e auditimit.

### *B.* PËRFUNDIMI

**Opinioni me rezervë**

Ne kemi audituar pasqyrat financiarete fushates per Organet e Qeverisjes Vendore te vitit 2019 te subjektit zgjedhor "Partia Social Demokrate", te cilat perfshijne fondet e perfituara dhe te shpenzuara gjate kesaj fushate.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejte, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë) te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara gjate fushates zgjedhore 2019, në pajtim me Kodin Zgjedhor, ligjin nr.8580, date 17.02.2000"Per

Partite Politike" (i ndryshuar) dhe ligjin nr.9228, date 29.04.2004 "per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

**Baza për opinionin me rezervë**

Pa dashur te ndyshojme opinionin tone,nedeshirojme te terheqim vemendjen per ceshtjet e meposhtme:

Subjekti zgjedhor "Partia Social Demokrate" :

1. Nuk ka hapur llogari te posacme bankare per fushaten zgjedhore sipas Kodit Zgjedhor e cila ndikon ne lidhje me transparencen e transaksioneve financiare te fushates;
2. Nuk jane deklaruar shpenzimet per anetare te keshillave bashkiake.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Partia në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

**LEJLA SHAHU**
**AUDITUES LIGJOR**

LEJLA SHAHU ( DOBI )
Auditues Ligjor
NIPT: K 82005005 S
TIRANË - ALBANIA